REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 826/20
Datë/Datum. 29.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues i prokurimit: *Valon Jahaj:* _____	*Data e autorizimit të ekspertit* **22/10/2020**	*Data e dorëzimit të raportit* **29/10/2020**

1. BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datë: 19.10.2020, **OE "Matrix IM" SH.P.K. - Prishtinë** ka parashtruar ankesë me nr. 826/20, kundër refuzimit të kërkesës për rishqyrtim në lidhje me aktivitetin e prokurimit me numër **"214-20-5756-2-2-1"**, me titull **"Krijimi dhe Mirembajtja e Sistemit te Centralizuar Elektronik për Pritje ne Radhë dhe Termine"**, iniciuar nga (AK) –**"MPB"**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, vlerë të mesme, lloji i kontratës: shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: 120,000.00€.

Datat për fazat e ndryshme të Aktivitetit të Prokurimit deri tek ankesa në OSHP janë si në vijim:
Data e përgatitjes së njoftimit për kontratë: 30.09.2020
Përgjigje në kërkesën për informata shtesë: 09.10.2020
Formulari standard për korrigjimin e gabimeve: 09.10.2020
Kërkesë për rishqyrtim: 06.10.2020
Vendimi për pezullimin e aktivitetit: 06.10.2020
Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: 09.10.2020
Ankesa në OSHP: 19.10.2020.

Konform nenit 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të LPP-së, eksperti shqyrtues ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. DISPOZITAT E SHKELURA NGA AK DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

OE ankues pretendon se AK ka shkelur:
Neni 7 - Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi i Ligjit Nr. 04/L-042 dhe ***Pika 18.9*** *e Udhëzuesit Operativ per Prokurimin Publik.*

Deklaratë e detajuar mbi faktet dhe argumentet e OE ankues.
Kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale, pervec tjerash keni kerkuar edhe:

1. Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar për menaxhimin e sigurisë së të dhënave me Certifikatë ISO 27001, valide. – Pretendimi 1

2. Arkitekt sistemi – Pretendimi 2
a. Diplomë përkatëse (kopje);
b. Certifikatë ne ASP.Net nga Microsoft ose organizate ekuivalente (kopje);
c. Referencë nga AK, duke specifikuar titullin e projektit, numrin e kontratës në të cilin ka qene i e angazhuar si Arkitekt sistemi sipas teknologjive ne kërkesë (kopje);
d. Referencë nga AK qe ka qene i e angazhuar si Arkitekt sistemi sipas teknologjive ne kërkesë (kopje);
e. CV.

3. Kërkesat Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet te ketë Stafin profesional për krijimin dhe mirëmbajtjen e këtij projekti, me sa vijon – Pretendimi 3
1. Një (1) Udhëheqës-Menaxher i projektit , i cili duhet
a. Të jetë i e diplomuar ose master në shkenca kompjuterike, ose inxhinieri softuerike, ose Inxhinieri Infromatike.
b. Të jetë i certifikuar ne PRINCE2 ose CAPM ose CMI;
c. Të jetë i e certifikuar nga Microsoft ose organizate ekuivalente;
d. Të jetë i e certifikuar nga Cisco ose organizate ekuivalente.
e. Përvojë pune minimumi 5 vite, në menaxhimin e projekteve.
f. Deklaratë për caktimin e Menaxherit të Projektit, nga ana e OE

5. Ekspert Dizajni për UI UX (1 Zyrtar), i cili duhet – Pretendimi 4
a. Të jetë i e diplomuar për Dizajnit Grafik;
b. Përvojë pune si Ekspert Dizajni për UI UX;
c. Përvojë pune si Dizajner për UI UX minimum 1 projekt me teknologji të bazuara në aplikacione mobile në Android dhe iOS.
d. Të ketë përvojë pune minimum 3 vjeçare.

6. Ekspert për kontrollë të cilësisë (1 Zyrtar), i cili duhet – Pretendimi 5
a. Të jetë i e diplomuar ose master në shkenca kompjuterike dhe ose inxhinieri;
b. Përvojë pune si ekspert për kontrollë të cilësisë minimum 1 projekt me teknologji të bazuara në .NET, ASP.NET.
c. Të ketë përvojë pune minimum 3 vjeçare.

11. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të dëshmoi se ka përfunduar me sukses të paktën tri (3) kontrata të zhvilluara në teknologji të Microsoft, të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë. Një kontratë prej tyre brenda institucioneve publike ose private të implementuara dhe zhvilluara me sukses në teknologji të Microsoft përmes paketës .NET Framework, teknologjisë ASP.NET MVC, gjuhës programuese C#. Një kontratë prej tyre për furnizim me pajisje të IT'së dhe avancim e mirëmbajtje të suksesshëm të softuerit te zhvilluar ne teknologji të Microsoft (Microsoft SQL Server dhe .NET Framework) i cili iu shërben të paktën 300 shfrytëzuesve. Një kontratë prej tyre për projekte të zhvilluara përmes teknologjive për pajisje mobile (angl.Mobile Native Development) në Android përmes gjuhës programuese Java dhe në iOS përmes gjuhës

programuese Swift.

11. Lista e kontratave, projekteve me të cilën saktësohen shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Plotësimi, nënshkrimi dhe vulosja e Aneksit nr. 6 te Dosjes se Tenderit, (Origjinal). Listës duhet ti bashkëngjiten dëshmi kopjen e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat dhe projektet e cekura në listë, (kopje). – Pretendimi 6

Sa i perket ketij dokumenti per IS27001 - Service managment, ju njoftojme se njejta eshte kerkese qe per here te pare po kerkohet ne aktivitet te ngjashem, pra sa i perket Furnizim me Sistem te radheve , dhe si e tille nuk eshte ne dispozicion te Operatoreve Ekonomik, konkretisht Kompanive qe operojne me furnizime, montime instalimit e sisteme te radheve, si dhe inxhinier te certifikuar ne ASP.net dhe nje referenc specifike qe kerkohet

Certifikaten ne fjale nuk besojme se posedon ndonje kompani qe ofron sherbime te furnizimit, (apo e ka vetem nje kompani favorizuese e Ak-së) sistemit te radheve , por edhe nese ndonje kompani e posedon ateher mund te jete vetem nje e tille ne tere territorin e Republikes se Kosoves, me c'rast ky kriter bie ndesh me Nenin 7 te LPP-se, pasi qe me kerkesen ne fjale AK nuk eshte duke i trajtuar te gjithe OE ne menyre te barabarte dhe eshte duke e reduktuar apo eleminuar konkurencen e lire ne mes te Operatoreve Ekonomik.

Gjithashtu konstatojme se Certifikata IS 27001, dhe kriteret e kerkuara lartcekuar per ASP.net dhe referencat e caktuar pervec qe eshte dokument i cili redukton apo eleminon konkurencen e lire eshte edhe certifikate e cila nuk korospodon me kete aktivitet.

Eshte e pa mundur, pa arsyeshme dhe e pa kuptimt qe Operatoret Ekonomik te bejne certifikime me ISO,dhe referecat e kerkuar per aspe dhe cilsine kontrollit, Standarde vetem se nje Autoritet Kontraktues ne dosje te tenderit e kerkon nje certifikate te tille, e e cila certifikate nuk sherben per asgje tjeter vetem se per permbushje te nje kriteri te vene nga AK, duke i'a shtuar faktet se nje certifikim i tille kerkon periudha te gjata kohore dhe kosto prej mijera Euro, e qe ne keto momente ne te cilat jemi duke kaluar per shkak te Pandemise Covid 19, edhe po te ishte deshira per nxerrjen e ketij dokumenti eshte e pa mundur te ftojme kompani per certifikim te tille dhe sigurimin e ketyre refeencave qe kerkojet per her te pare per furnzimie te sistemit te radhve ne Kosove.

Si perfundim, duke pasur parasysh qeshtjen e lartecekur, kerkojme nga AK – ministra e puneve te brenshme tee ktheje kete aktivitet ne ri-vleresim, me c'rast propozojme qe kriteri i lartecekur te hiqet ne teresi nga Dosja e Tenderit.

KONKLUZION: Kerkojme nga OSHP-ja qe te beje anulimin e ketyre kriterve ose te anuloj aktiviteti e prokuirmit REKOMANDOHET qe ky Aktivitet te kthehet ne Ritender dhe te zbuten kriteret-pasi qe boterish shihet qe jan diskriminuese dhe jan favorizuese per biznes te caktuar.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET ANKIMORE

***Fakti 1:* Paragrafi 18.9 i RRUOPP dhe neni 7 i LPP-së**

18.9 Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë <u>që nuk</u>:

- Kufizon konkurrencën në mesin e OE. ose
- Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë EO-ve.

Neni 7
Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkese të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë: (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

Fakti 2: ***Kerkesat tek Pershtatshmeria profesionale***

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
4. Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar për menaxhimin e sigurisë së të dhënave me Certifikatë ISO 27001, valide.	**4. Certifikatë profesionale - ISO 27001, (kopje).**

Fakti 3. ***Për pretendimin 2.***

3. Arkitekt i Sistemit (1 Zyrtar), i cili duhet a. Të jetë i e diplomuar ose master në shkenca kompjuterike, ose inxhinieri softuerike, ose inxhinieri kompjuterike; b. Të jetë i e certifikuar ne ASP .Net nga Microsoft ose organizate ekuivalente; c. Përvojë pune si arkitekt sistemi minimum 1 projekte me teknologji të bazuara në .NET, ASP.NET; d. Përvojë pune si arkitekt sistemi minimum 1 projekte me teknologji të bazuara në aplikacione mobile në Android dhe iOS., e. Të ketë përvojë pune minimum 3 vjeçare.	**3. Arkitekt sistemi a. Diplomë përkatëse (kopje); b. Certifikatë ne ASP .Net nga Microsoft ose organizate ekuivalente(kopje); c. Referencë nga AK, duke specifikuar titullin e projektit, numrin e kontratës në të cilin ka qene i e angazhuar si Arkitekt sistemi sipas teknologjive ne kërkesë (kopje); d. Referencë nga AK qe ka qene i e angazhuar si Arkitekt sistemi sipas teknologjive ne kërkesë (kopje); e. CV;**

Fakti 4: ***Për pretendimin 3.***

Kërkesat Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet te ketë Stafin profesional për krijimin dhe mirëmbajtjen e këtij projekti, me sa vijon 1. Një (1) Udhëheqës-Menaxher i projektit , i cili duhet a. Të jetë i e diplomuar ose master në shkenca kompjuterike, ose inxhinieri softuerike, ose Inxhinieri Infromatike. b. Të jetë i certifikuar ne PRINCE2 ose CAPM ose CMI; c. Të jetë i e certifikuar nga Microsoft ose organizate ekuivalente; d. Të jetë i e certifikuar nga Cisco ose organizate ekuivalente. e. Përvojë pune minimumi 5 vite, në menaxhimin e projekteve. f. Deklaratë për caktimin e Menaxherit të Projektit, nga ana e OE pjesëmarrës.	**Dëshmitë Lista e kualifikimeve profesionale dhe edukative e stafit të kërkuar 1. Udhëheqës-Menaxher i projektit a. Diplomë perkatëse (kopje); b. Certifikatë për PRINCE2 ose CAPM ose CMI (kopje); c. Certifikatë nga Microsoft ose organizate ekuivalente, (kopje); d. Certifikatë për CCNA II ose organizate ekuivalente, (kopje); e. CV; f. Vendimin për menaxher të projektit (origjinal).**

Fakti 5: ***Për pretendimin 4 dhe 5.***

5. Ekspert Dizajni për UI UX (1 Zyrtar), i cili duhet a. Të jetë i e diplomuar për Dizajnit Grafik; b. Përvojë pune si Ekspert Dizajni për UI UX; c. Përvojë pune si Dizajner për UI UX minimum 1 projekt me teknologji të bazuara në aplikacione mobile në Android dhe iOS. d.Të ketë përvojë pune minimum 3 vjeçare.	**5. Ekspert Dizajni për UI UX a. Diplomë universitare minimum Bachelor ne Dizajn Grafik (kopje); b. Referencë nga punëdhënësi, duke specifikuar titullin e projektit, numrin e kontratës në të cilin ka qene i e angazhuar si Ekspert Dizajni për UI UX (kopje); c. Referencë nga AK qe ka qene i e angazhuar si Dizajner për UI UX sipas teknologjive ne kërkesë (kopje); d. CV;**
6. Ekspert për kontrollë të cilësisë (1 Zyrtar), i cili duhet a. Të jetë i e diplomuar ose master në shkenca kompjuterike dhe ose inxhinieri; b. Përvojë pune si ekspert për kontrollë të cilësisë minimum 1 projekt me teknologji të bazuara në .NET, ASP.NET. c. Të ketë përvojë pune minimum 3 vjeçare.	**6. Ekspert për kontrollë të cilësisë së projektit a. Diplomë perkatëse (kopje); b. Referencë nga punëdhënësi, duke specifikuar titullin e projektit, numrin e kontratës në të cilin ka qene i e angazhuar si ekspert për kontrollë të cilësisë dhe auditim sipas teknologjive ne kërkesë (kopje); c. CV;**

Fakti 6: ***Pjesë nga specifikacioni teknik***

1.3. Sistemi për menaxhimin e termineve "Online"

Ky sistem duhet të jetë i qasshëm 24/7 për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës përmes pajisjeve kompjuterike dhe mobile.

Sistemi duhet të jetë i bazuar në ueb, të jetë i përshtatshëm për lloje të ndryshme të pajisjeve mobile dhe kompjuterike dhe gjithashtu të posedojë aplikacion të posaçëm (angl. Native) për platformat Android dhe iOS.
Kompania fituese duhet të bartë koston e hapjes së llogarive për Google Play dhe App Store gjate mirëmbajtjes dhe duhet të jetë e gatshme në ç'do kohë kur ARC e sheh të nevojshme hapjen e llogarive dhe publikimin e aplikacioneve.

Gjithashtu, duhet Te jete opsioni i terminëve me gjenerim te fletëpagesave dhe me mundësi te pagesës online.

KY sistem duhet të jetë i ndarë në katër softuer me shërbimet si më poshtë:

1.Softueri "Online" për menaxhimin e termineve
   a. Moduli për ndarje të terminit
   b. Moduli për posedim të dëshmisë
2.Softueri i brendshëm për evidentimin, verifikimin dhe konfigurimin e termineve
   a. Moduli për evidentimin e listës së termineve sipas kalendarit (angl. Scheduler) dhe printimin e tyre sipas nevojës
   b. Moduli për kërkime të avancuara
   c. Moduli për konfigurim të termineve
3.Softueri i bazuar në Android për ndarje të termineve
   a. Moduli për ndarje të terminit
   b. Moduli për posedim të dëshmisë
4.Softueri i bazuar në iOS për ndarje të terminëve
   a. Moduli për ndarje të terminit
   b. Moduli për posedim të dëshmisë
5.Moduli për barazimin e pagesave dhe gjenerimin e faturave te ndryshme
   a. Barazimi dhe gjenerimi i fletëpagesave dhe
   b. Mundësinë e pagesave online nga qytetaret për termine te caktuara ne versionin ueb por edhe ne versionet me Android dhe me iOS.

***Fakti 7:* Pjesë nga përgjigja e AK në kërkesen për sqarime**

2.	Referimi 2: Në FTD tek "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" keni kërkuar që menaxheri i projektit të plotësojë pikën "b) Të jetë i certifikuar ne PRINCE2 ose CAPM ose CMI". Pytja 2: A është e pranueshme dhe a mund të plotësohen këto çertifikime nëse menaxheri i projektit është i/e diplomuar në "Menaxhim të Teknologjisë së Informacionit" nga institucionet universitare apo kolegjet universitare?	Po është e pranueshme.
3.	*Referimi 3: Në FTD tek "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" keni kërkuar që arkitekti i sistemit të plotësojë pikën "a) Të jetë i e diplomuar ose master në shkenca kompjuterike, ose inxhinieri softuerike, ose inxhinieri kompjuterike".* *Pytja 3: A është kërkuar që arkitekti i sistemit të jetë Bachelor i diplomuar në Shkenca Kompjuterike ose Inxhinieri Softuerike apo jeni duke kërkuar inxhinier të diplomuar (sistem të atëhershëm katër vjeqar) apo Master në Shkenca Kompjuterike?*	Ne jemi duke kërkuar që arkitekti i sistemit të jetë i diplomuar në nivelin Master në Shkenca Kompjuterike ose Inxhinieri Softuerike ose Inxhinier i diplomuar në Shkenca Kompjuterike ose Inxhinieri Kompjuterike (sistemi katër vjeçar).
4.	*Referimi 4: Në FTD tek "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" keni kërkuar që eksperti për kontrollë të cilësisë të plotësojë pikën "a) Të jetë i e diplomuar ose master në shkenca kompjuterike dhe ose inxhinieri"* *Pytja 4: A është kërkuar që eksperti për kontrollë të cilësisë të jetë Bachelor i diplomuar në Shkenca Kompjuterike ose Inxhinieri Softuerike apo jeni duke kërkuar inxhinier të diplomuar (sistem të atëhershëm katër vjeqar) apo Master në Shkenca Kompjuterike?*	Ne jemi duke kërkuar që eksperti për kontrollë të cilësisë të jetë i diplomuar në nivelin Master në Shkenca Kompjuterike ose Inxhinieri Softuerike ose Inxhinier i diplomuar në Shkenca Kompjuterike ose Inxhinieri Kompjuterike (sistemi katër vjeçar).
5.	*Referimi 5: Në FTD tek "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" keni kërkuar që eksperti për trajnime të plotësojë pikën "b) Përvojë pune si ekspert për kontrollë të cilësisë minimum 1 projekt me teknologji të bazuara në .NET, ASP.NET".* *Pytja 5: A është menduar përvojë pune si ekspert për trajnime në teknologji të bazuara në .NET dhe ASP.NET?*	Po, ky është një gabim teknik. Është menduar "ekspert për trajnime" dhe jo "ekspert për kontrollë të cilësisë".

4. RAPORTI I KOMISIONIT RIVLERËSUES

N/A ankesa është në kritere diskriminuese tëk Kushtet për pjesëmarrje dhe kapaciteti teknik dhe profesional.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË ANKESËS

OE ankues pretendon se në ketë aktivitet të prokurimit publik nga ana e AK-së janë shkelur: Neni 7 i LPP-së dhe neni 18 paragrafi 9 i RRUOPP të paraqitura edhe si **fakt 1** të kësaj ekspertize.

Përshkrim i përgjithshëm

Me ketë aktivitet te prokurimit AK ka kërkuar krijim, furnizim, instalim, përshtatje me kërkesa dhe mirëmbajtje te sistemit për 30 muaj për Agjensionin e Regjistrimit Civil në kuadër të MPB, kjo e cekur në NJK dhe DT, te sistemit te menaxhimit të rendit dhe caktimin e terminëve si dhe ndërlidhjen e plotë e tij me infrastrukturen e TI-së me të cilën posedon AK, duke përfshirë aty informata që kanë të bejnë me të dhënat private të personave që marrin shërbime.

Me anë të këtij sistemi te cetralizuar të pritjes në rradhë dhe caktimit të termineve, do të eleminohen pritjet e gjata dhe rradhet pranë sporteleve të ARC-së nga ana e qytetareve për të pranuar shërbime.
Keto pajisje dhe aplikacione përfshijnë: Pajisjet harduerike për menaxhimin e radhës me komponentët përcjellese, Sistem (softuerik) të centralizuar për menaxhimin e radhës; Sistem softuerik për menaxhimin e terminëve dhe Modulin softuerik për menaxhimin e ruajtjes, rikthimit, transferit dhe ndërlidhjes së informatave nga ky sistem me sistemet tjera të cilat AK tashmë i ka në përdorim. Si dhe ta përmbajë edhe Sistemin për menaxhimin e termineve "Online" i qasshëm 24/7 për të gjithë qytetarët e Kosovës përmes pajisjeve kompjuterike dhe mobile.

Sistemi duhet të jetë i bazuar në ueb, të jetë i përshtatshëm për lloje të ndryshme të pajisjeve mobile dhe kompjuterike dhe gjithashtu të posedojë aplikacion të posaçëm (angl. Native) për platformat Android dhe iOS si dhe duhet te jete opsioni i terminëve me gjenerim te fletëpagesave dhe me mundësi te pagesës online. E tera kjo qe qytetaret të caktojne termine "online" dhe madje edhe pagesat të kryhen "online" nga ta, në menyrë që fare pak ose aspak të kenë interaksion fizik ndërmjet vete.

Nga të tëra këto informata kuptohet se AK nuk ka kërkuar thjeshtë Sistem te Menaxhimit të rendit te përbërë vetem nga pajisjet Harduerike të ndërlidhura në mes vete dhe një softuer menaxhues të tyre dhe me mundësinë e eksportimit te të dhënave në lidhje me sherbimet e realizuara në ndonjë aplikacion tjetër të AK-së, por ka kerkuar sistem shumë me të komplikuar dhe shumë më të pershtatshem për ta, i cili do të ndërlidhte informatat në lidhje me sherbimet e dhëna me shenimet e personave që kanë marr shërbim, duke u lidhur në kohë reale me sistemet e tjera të AK-së dhe duke eleminuar punën e dyfishtë të punetorëve në sportele të AK-së, pra qe ata të mos kenë nëvojë te kyqen në sistemin aktual të tyre që të bëjnë procesimin e dokumenteve por ashtu siq e kanë dhënë shërbimin për qfarëdo arsye i njejti të procesohet me tutje, siq është e cekur edhe në specifikacionin teknik te DT në foton në vijim:

Komponenti 3 - Kërkesat teknike për mekanizmin për integrim me sistemet e ARC-së (sistemet që ARC veçse i ka në përdorim) janë si me poshtë:

Kompania fituese duhet të jetë e gatshme në ç'do kohë që ARC i kërkon të ofrojë dhe implementojë mekanizmin për ndërlidhje me sistemet që ARC veçse i ka në përdorim. Ai mekanizëm duhet të jetë i integrueshëm brenda sistemeve të ARC-së dhe zyrtari të mos ketë nevojë pasi që ta përfundojë rastin të hapë sistemin tjetër për të sinjalizuar palën e radhës por duhet të integrohet në mënyrë automatike ku pas përfundimit të shërbimit shfaqet numri i radhës që është në pritje.

Për të ilustruar kërkesën e mësipërme të bashkangjitur gjeni rrjedhën e punës që do të duhej të ndodhë pas implementimit të këtij sistemi:

1. Zyrtari hapë rastin në sistemin të cilin punon (Letërnjoftim, Pasaporte, Patenteshofer, Regjistrim i Automjeteve, Vulat Apostile, e të tjera)
2. Zyrtari plotëson fushat e nevojshme dhe përfundon rastin
3. Sistemi dërgon informatën në mekanizmin e ofruar nga operatori ekonomik i cili duhet të përshtatet sipas kërkesave të ARC-së
4. Sistemi i radhës shfaqë në ekran numrin e palës që është në radhë për të realizuar shërbimin

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues.

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë me kushtet për pjesëmarrje te OE, konkretisht pika III.2.2. Përshtatshmëria Profesionale dhe pika III.2.4. Kërkesat për Kapacitetin Teknik dhe Profesional.

Këto pretendime te OE ankues i kam ndarë, shqyrtuar dhe përgjigjur si në vijim.

Pretendimi 1: *Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar për menaxhimin e sigurisë së të dhënave me Certifikatë ISO 27001, valide*

Përgjigje në pretendimin 1. Kërkesa nga AK për ketë certifikatë (*fakti 2*) për mendimin tim është plotësisht e arsyeshme, duke e marrë parasysh kompleksitetin e komunikimit, ndërlidhjen dhe qasjen e këtij sistemi në sistemet me te cilat AK tashme posedon e të cilat përmbajnë informata personale të individëve.
Certifikata ISO 27001 është standard ndërkombetar që përcakton specifikimet për një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS) me qëllim që te ndihmojë organizatat të menaxhojnë sigurinë e informacionit të tyre, e që është rasti konkret ne aktivitetin e prokurimit në fjalë. Për më shumë kliko në linkun në vijim:
https://www.iso.org/isoiec-27001-information-security.html

Përfitimet që ju ofronë kjo certifikatë organizatave ndër të tjera janë edhe: mbrojtja konfidencialitetit të informacionit, siguron integritetin e të dhënave dhe disponueshmërinë e sistemeve të TI-së. Demonstrimi para palëve të interesit dhe klientëve se sistemi përmbanë standardet më të larta për sigurinë e informacionit etj.
Duke i marrë parasysh këto informacione të cekura propozoj që **pretendimi 1** i OE ankues të refuzohet **si i pabazuar** nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së. Dhe te mbetet kërkesa për certifikaten ISO 27001, që për mendimin tim është kërkesë në përputhje me nenin 70 të LPP-së "Standardet për Sigurimin e Cilësisë" dhe në përputhje me nenin 28 të LPP-së "Specifikimet Teknike.

Pretendimi 2: *Arkitekt Sistemi*

Përgjigje në pretendimin 2. Me analizimin e kësaj pike ankimore, kontrollimit te DT dhe specifikacionit teknik të saj, faktit 3 – "kërkesat e AK" dhe faktit 7 – "Përgjigja sqaruese e AK-së", të bashkangjitura në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues sqaron se janë 4 komponente kryesore nga të cilat përbehët sistemi, të cilin e ka kërkuar AK në ketë aktivitet të prokurimit dhe për të gjitha këto i ka cekur në aneksin 1 "specifikacioni teknik" teknologjitë që duhen përkrahur dhe dorëzimin obligativ te kodit burimor për të gjitha komponentet, siq shihet edhe në fotot më poshtë:

1.2. Sistemi i Centralizuar për Menaxhimin e Radhës

Ky sistem të mundësojë që përmes tij të bëhet menaxhimi i centralizuar i radhës nëpër sportelet e ARC-së për të gjitha shërbimet që ofron ARC.

Sistemi duhet të jetë dinamik ku do të mundësojë menaxhimin e centralizuar te shërbimeve (heqjen dhe shtimin) në të ardhmen, përditësimin e informatave si dhe të përshtatet për pajisje tjera kompjuterike që ARC mund ti përdorë.

Ky sistem duhet të jetë i ndarë në katër komponentë si më poshtë:

1. **Komponenti 1** -Softueri për menaxhimin e radhës nga pajisja i cili lidhet ngushtë me pajisjet me numër #1.1 (Pajisja për menaxhimin e radhës dhe komponentët përbërëse);
2. **Komponenti 2** - Softueri i bazuar në ueb për menaxhim të pajisjeve (menaxhim të shërbimeve dhe nxjerrje të raporteve në nivel të pajisjeve dhe shërbimeve);
3. **Komponenti 3** - Mekanizmi për integrim te këtij sistemi me sistemet tjera te ARC-së (sistemet që ARC veçse i ka në përdorim);
4. **Komponenti 4** - API për komunikim ndërmjet bazës së të dhënave dhe sistemit për menaxhimin e radhës.

Teknologjitë për komponentin 1:

- DOT.NET
- Windows Forms
- C#
- MS SQL Server 2019
- Entity Framework
- HTML5
- CSS3
- RDLC Reports

Kodi burimor:

Kodi burimor duhet ti dorëzohet autoritetit kontraktues për të gjitha komponentët sipas teknologjive të kërkuara.

Roli i Arkitektit te sistemit në sistemet e teknologjisë së informacionit është të analizoj dhe rekomandoj kombinimin e duhur të përbërësve të IT për të arritur një qëllim specifik të AK-së. Ai i analizon në menyrë objektive proceset dhe i japë këshillat e duhura për të arritur rezultatet e dëshiruara.
Që pozita e Arkitektit te Sistemit me specifikat e kërkuara është e domosdoshme në ketë Aktivitet të Prokurimit ceket në disa vende në specifikacion teknik të DT ku ndër të tjera AK kërkon të plotësohen kërkesat, si në vijim.

1.7.3. OPERATORI EKONOMIK KA PËR OBLIGIM QË PAS REALIZIMIT TE KËRKESAVE, TË BËJ NJË PREZANTIM PARA EKIPIT TË PROJEKTIT TEK AUTORITETI KONTRAKTUES DHE TE BËJË NDRYSHIMET E NEVOJSHME NË RAST NEVOJE. PAS SECILËS FAZË TE ZHVILLIMIT, OPERATORI EKONOMIK DUHET TE RAPORTOJ ME SHKRIM TEK MENAXHERI I PROJEKTIT NE ARC DHE TE KËRKOJ MIRATIMIN PARAPRAK PËR PUNËN E KRYER.

1.7.4. SRT DUHET TE JETE I INTEGRUESHËM DHE TE INTEGROHET ME APLIKACIONE DHE SISTEME TE TJERA TE NATYRËS SE NGJASHME, APO ATY KU TE DHËNAT E SISTEMIT MUND TE SHËRBEJNË SI INPUT OSE OUTPUT PËR SISTEME TE TJERA DHE ANASJELLTAS.

1.7.5. OPERATORI EKONOMIK DUHET TË KETË PARASYSH SE DUHET TË PËRGJIGJET DHE TE REALIZOJË CILËN DO KËRKESË QË PARAQITET NGA ARC DHE QË NDËRLIDHET ME PROJEKTIN NË TËRËSI.

1.7.8. OPERATORI EKONOMIK E KA PËR OBLIGIM TË ANALIZOJ PROCESIN E PUNËS DHE TE MARR PARASYSH TE GJITHA KËRKESAT QE DALIN NGA ARC NE ASPEKTIN LIGJOR APO TEKNIK. CDO GJË QE DO TE ZHVILLOHET DO TE BEHET KONFORM LIGJEVE, UDHËZIMEVE ADMINISTRATIVE, RREGULLOREVE, PROCEDURAVE PËRKATËSE TE PUNËS POR EDHE SIPAS KËRKESAVE NGA ARC, NDËRSA NE ASPEKTIN TEKNIK PRESIM ZGJIDHJEN ME TE MIRË NGA ANA E OPERATORIT EKONOMIK.

1.7.9. KOMPANIA DUHET TË KETË PARASYSH SE MUND TË PARAQITEN KËRKESA TË REJA GJATË FAZËS SË ANALIZËS, ZHVILLIMIT, IMPLEMENTIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË SRT LIDHUR ME DIZAJNIN APO PËRBËRJEN E MODULEVE APO PJESËVE TË CAKTUARA TE SRT-SË, TË CILAT ËSHTË E OBLIGUAR T'I IMPLEMENTOJ.

1.7.10. KOMPANIA KONTRAKTUESE DUHET TË MUNDËSOJ QE PËR CDO NDRYSHIM TE GJENDJEVE TE PROCESEVE, GJENDJA E MËHERSHME TE MBETET SI HISTORI NDËRSA TE JETE AKTIVE VETËM GJENDJA AKTUALE E PROCESEVE, QE PËRFSHIN HISTORIKUN E VEPRIMEVE NGA MOMENTI I QASJES NE SISTEM DHE PËR TE GJITHA VEPRIMET E REALIZUARA.

Andaj duke marrë parasysh kompleksitetin e zgjidhjes së kërkuar si terësi e komponentëve harduerike dhe softuerike, e shoh si të arsyeshme kërkesën e AK për diplomen, certifikatat, referencat dhe CV etj, të kërkuara për poziten e Arkitektit te Sistemit të bazuara në teknologjitë e kërkuara nga AK, të cekura në specifikacionin teknik dhe të paraqitura nga eksperti shqyrtues në fotot e mësiperme.
Propozoj që **Pretendimi 2** të refuzohet si **i pabazuar** nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Pretendimi 3. *Kërkesat Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet te ketë Stafin profesional për krijimin dhe mirëmbajtjen e këtij projekti, me sa vijon ...*

1. Një (1) Udhëheqës-Menaxher i projektit , i cili duhet
a. Të jetë i e diplomuar ose master në shkenca kompjuterike, ose inxhinieri softuerike, ose Inxhinieri Infromatike.
b. Të jetë i certifikuar ne PRINCE2 ose CAPM ose CMI;
c. Të jetë i e certifikuar nga Microsoft ose organizate ekuivalente;
d. Të jetë i e certifikuar nga Cisco ose organizate ekuivalente.
e. Përvojë pune minimumi 5 vite, në menaxhimin e projekteve.
f. Deklaratë për caktimin e Menaxherit të Projektit, nga ana e OE

Përgjigje në pretendimin 3. Me analizimin e kësaj pike ankimore, kontrollimit te DT dhe specifikacionit teknik të saj, faktit 4 – kërkesave dhe faktit 7 – Përgjigja e AK-së në kërkesën për sqarime ku shihet si më poshtë, konkretisht përgjigja e AK-së në pyetjen 2.

2.	Referimi 2: Në FTD tek "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" keni kërkuar që menaxheri i projektit të plotësojë pikën "b) Të jetë i certifikuar ne PRINCE2 ose CAPM ose CMI".	Po është e pranueshme.
	Pytja 2: A është e pranueshme dhe a mund të plotësohen këto çertifikime nëse menaxheri i projektit është i/e diplomuar në "Menaxhim të Teknologjisë së Informacionit" nga institucionet universitare apo kolegjet universitare?	

Me ç'rast kërkesa për certifikatat për menaxhim te projekteve "PRINCE2 ose CAPM ose CMI" ekuivalentohen me diploma universitare dhe referenca përkatëse, kurse kërkesat tjera janë në përputhje me specifikat teknike dhe kërkesat në dosjen e tenderit, andaj si të tillë pretendimin ankimor 3 e konsideroj **si të pabazuar.**

Pretendimi 4 dhe 5. *Ekspert Dizajni për UI UX (1 Zyrtar)...dhe Ekspert për kontrollë të cilësisë (1 Zyrtar)*

Përgjigje në pretendimin 4 dhe 5. Me analizimin e këtyre pikave ankimore, kontrollimit të DT dhe specifikacionit teknik të saj, faktit 5 të bashkangjitur në ketë ekspertizë, shihet se AK për pozitën "Ekspert Dizajni" ka kërkuar nga OE të plotësojnë kriterët si në vijim:
a. Të jetë i e diplomuar për Dizajnit Grafik;
b. Përvojë pune si Ekspert Dizajni për UI UX;
c. Përvojë pune si Dizajner për UI UX minimum 1 projekt me teknologji të bazuara në aplikacione mobile në Android dhe iOS.
d. Të ketë përvojë pune minimum 3 vjeçare.

Ndërsa si deshmi dokumentare janë kërkuar si më poshtë

5. Ekspert Dizajni për UI UX (1 Zyrtar), i cili duhet a. Të jetë i e diplomuar për Dizajnit Grafik; b. Përvojë pune si Ekspert Dizajni për UI UX; c. Përvojë pune si Dizajner për UI UX minimum 1 projekt me teknologji të bazuara në aplikacione mobile në Android dhe iOS. d.Të ketë përvojë pune minimum 3 vjeçare.	**5. Ekspert Dizajni për UI UX a. Diplomë universitare minimum Bachelor ne Dizajn Grafik (kopje); b. Referencë nga punëdhënësi, duke specifikuar titullin e projektit, numrin e kontratës në të cilin ka qene i e angazhuar si Ekspert Dizajni për UI UX (kopje); c. Referencë nga AK qe ka qene i e angazhuar si Dizajner për UI UX sipas teknologjive ne kërkesë (kopje); d. CV;**

Te kjo pjesë mendoj qe të gjitha kërkesat AK-së janë të arsyeshme, e kryesorja është pjesa për diplomë nga lëmia e Dizajnit Grafik, pozitë kjo e cila përpos që mbulohet-arsyetohet me referenca dhe CV për përvojen e duhur, duhet edhe deshmi bindëse për pergaditjen teknike dhe profesionale te saj.

Ndërsa AK për poziten "Ekspert për Kontrollë të cilësisë" ka kërkuar të plotësohen:
a. Të jetë i e diplomuar ose master në shkenca kompjuterike dhe ose inxhinieri;
b. Përvojë pune si ekspert për kontrollë të cilësisë minimum 1 projekt me teknologji të bazuara në

.NET, ASP.NET.
c. Të ketë përvojë pune minimum 3 vjeçare.

Ndërsa si kërkesë për plotësim është si më poshtë:

6. Ekspert për kontrollë të cilësisë (1 Zyrtar), i cili duhet a. Të jetë i e diplomuar ose master në shkenca kompjuterike dhe ose inxhinieri; b. Përvojë pune si ekspert për kontrollë të cilësisë minimum 1 projekt me teknologji të bazuara në .NET, ASP.NET. c. Të ketë përvojë pune minimum 3 vjeçare.	**6. Ekspert për kontrollë të cilësisë së projektit a. Diplomë perkatëse (kopje); b. Referencë nga punëdhënësi, duke specifikuar titullin e projektit, numrin e kontratës në të cilin ka qene i e angazhuar si ekspert për kontrollë të cilësisë dhe auditim sipas teknologjive ne kërkesë (kopje); c. CV;**

Pretendimi i OE ankues tek kjo pikë, aq sa e kam kuptuar unë dhe duke e ndërlidhur edhe me pretendimin e rradhës, është tek certifikimi i zyrtarit të emruar nga OE për pozitën e ekspertit te kontrollit të cilësisë në teknologjinë **ASP.NET.** Konfirmoj që as në NJK as në DT nuk kërkohet që zyrtari të jetë i certifikuar, por kërkohet përvojë pune në të pakten 1 projekt për kontrollë të cilësisë, e cila duhet të mbulohet me referencë nga "Punëdhenësi" që ka qenë i angazhuar në 1 projekt të punuar në .NET, ASP.NET. Kjo shihet edhe në foton e mësiperme.
Kurse pse është e nëvojshme përvoja për ketë projekt edhe në teknologjinë ASP.NET e cila teknologji është një kornizë e aplikacioneve "Open Source", në anën e serverit, e krijuar nga "Microsoft" që ju mundëson zhvilluesve të krijojnë aplikacione në internet, shërbime në internet dhe web faqe etj. E'që ndërlidhet plotësisht me kërkesat e AK-së.
Duke i marrë parasysh të gjeturat dhe rekomandimet qe i kam cekur për keto dy pretendime ankimore, mendoj që të dy këto pretendime të refuzohen **si të pa bazuara** nga ana e PSH të OSHP-së.

Pretendimi 6. *Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të dëshmoi se ka përfunduar me sukses të paktën tri (3) kontrata të zhvilluara në teknologji të Microsoft, të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë. Një kontratë prej tyre brenda institucioneve publike ose private të implementuara dhe zhvilluara me sukses në teknologji të Microsoft përmes paketës .NET Framework, teknologjisë ASP.NET MVC, gjuhës programuese C#. Një kontratë prej tyre për furnizim me pajisje të IT'së dhe avancim e mirëmbajtje të suksesshëm të softuerit te zhvilluar ne teknologji të Microsoft (Microsoft SQL Server dhe .NET Framework) i cili iu shërben të paktën 300 shfrytëzuesve. Një kontratë prej tyre për projekte të zhvilluara përmes teknologjive për pajisje mobile (angl.Mobile Native Development) në Android përmes gjuhës programuese Java dhe në iOS përmes gjuhës programuese Swift.*

Përgjigje në pretendimin 6. Me analizimin e kësaj pike ankimore, kontrollimit të DT dhe specifikacionit teknik të saj, faktit 6 *(pjesë nga specifikacioni teknik)* të bashkangjitur në ketë ekspertizë, AK ka kërkuar si deshmi për përvojë, si me poshtë:

11. Lista e kontratave, projekteve me të cilën saktësohen shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Plotësimi, nënshkrimi dhe vulosja e Aneksit nr. 6 te Dosjes se Tenderit, (Origjinal). Listës duhet ti bashkëngjiten dëshmi kopjen e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat dhe projektet e cekura në listë, (kopje).

Te cilat kërkesa janë në përputhje me kompleksitetin e sistemit te cilin e ka kërkuar AK dhe është e domosdoshme që OE që do të shpërblehet me kontratë te ketë përvojën e duhur për të implementuar ketë sistem.

Ndërsa tek pjesa ku kërkohet një kontratë për projekte të zhvilluara për pajisje mobile si më poshtë:

shfrytëzuesve. Një kontratë prej tyre për projekte të zhvilluara përmes teknologjive për pajisje mobile (angl. Mobile Native Development) në Android përmes gjuhës programuese Java dhe në iOS përmes gjuhës programuese Swift.

Është shumë e rendësishme sidomos pjesa kur AK ka kërkuar që për pajisjet mobile te pajisura me sistemin Operativ Android të jetë i zhvilluar përmes gjuhës programuese "Java" ndërsa për pajisjet e Apple me sistemin operativ iOS te jenë në gjuhën programuese "Swift", të dy këto gjuhë programuese "Open Source" me qasje te lirë për këdo që ka njohuri te programoj aplikacione në to, pa kufizime dhe sipas kërkesave dhe specifikave përkatëse dhe kështu ka vepruar njejtë edhe tek kërkesa aplikacione të zhvilluara në teknologjinë ASP.NET që i përket platformës "Microsoft" dhe njejtë është e hapur dhe e qasshme për të gjithë që kanë njohuri.
Nga te tëra këto shihet trajtimi i barabartë dhe ofrimi i kushteve të barabarta nga AK të konkurimit në mes të OE. Andaj edhe këtë pretendim ankimor te OE ankues propozoj qe të refuzohet si **i pa bazuar**.

Për fund konsideroj se AK gjatë zhvillimit deri me tani të këtij Aktiviteti të Prokurimit, duke marrë parasysh kërkesat e përgjithshme dhe të veqanta të zgjedhjës se kërkuar si tërësi, e ka përgaditur në menyrë të detajuar dhe profesionale Njoftimin për Kontratë, Dosjen e Tenderit, Aneksin 1 – Specifikacionin Teknik të Tenderit, është pergjigjur në kohë ne kërkesat për sqarime, e ka pezulluar proceduren me rastin e pranimit të kërkesës për rishqyrtim dhe pastaj e ka shtyer afatin për dorëzim te tenderëve, të gjitha këto në përputhje me Ligjin e prokurimit publik.

8. MENDIMI I EKSPERTËVE SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, hulumtimet, krahasimet, sqarimet dhe të gjeturat tjera të cekura në ketë ekspertizë, eksperti shqyrtues i prokurimi i propozonë Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohët si **e pabazuar**, të obligohet AK që të vazhdojë me Aktivitetin e Prokurimit në përputhje me LPP-në dhe legjislacionin sekondar të prokurimit publik.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues "MPB"
- Panelit Shqyrtues "OSHP"
- OE ankues "Matrix IM" SH.P.K.